

Statistikat e Transportit Detar

Tremujori I, 2024

Tiranë, më 29 Prill 2024: Në Shqipëri operojnë katër porte detare të cilët shërbejnë për transport mallrash: Porti i Durrësit, Vlorës, Shëngjinit dhe porti i Limjonit (Sarandë). Porti i Durrësit është porti kryesor në vend prej të cilit janë transportuar 96,0 % e volumit të mallrave të transportuar me det, ose 1.606 mijë ton mallra. Volumi gjithsej i mallrave të transportuara nga porti i Durrësit është rritur me 3,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1: Volumi i mallrave sipas porteve detare, 000/ton

Mallra 000/ton	TR I – 2022	TR II – 2022	TR III – 2022	TR IV – 2022	TR I – 2023	TR II – 2023	TR III – 2023	TR IV - 2023	TR I - 2024
Portet	1.426	1.540	1.686	1.597	1.619	1.713	1.688	1.739	1.673
Durrës*	1.359	1.473	1.619	1.526	1.553	1.608	1.618	1.641	1.606
Import	990	1037	1.337	1.216	1.237	1.257	1.303	1.254	1.280
Eksport	369	436	282	310	316	351	315	387	326
Vlorë	22	28	27	30	19	30	37	44	38
Import	12	17	17	18	10	20	25	33	31
Eksport	10	11	10	12	9	10	12	11	7
Sarandë (Limjoni)	14	11	7	9	13	31	4	10	9
Import	6	8	4	6	8	12	4	10	9
Eksport	8	3	3	3	5	19	0	0	0
Shëngjin	31	28	33	31	33	44	29	44	20
Import	13	12	17	19	23	36	17	32	13
Eksport	18	16	16	12	10	8	12	12	7

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

*Në të dhënat e Portit të Durrësit përfshihet edhe volumi i mallrave të transportuara nga Porti koncesionar i Porto Romanos

Llojet e grup-mallrave kryesore të transportuara nëpërmjet rrugëve detare sipas klasifikimit, NST 2007 (Nomenklatura e Statistikave të Transportit), për tremujorin e parë 2024 paraqiten si më poshtë:

- Grupi "Metale bazë; produkte metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve" përbën 17,1 % të mallrave të transportuara nga portet;
- Grupi "Koks dhe produktet e rafinuara të naftës" përbën 14,7 % të mallrave të transportuara;
- Grupi i mallrave "Produkte të tjera minerale (jo metalike)" përbën 10,5 % të mallrave të transportuara;

Për publikim 29/04/2024

- Grupi i mallrave "Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror" përbën 7,3 % të mallrave të transportuar.

Tab.2: Transporti detar i mallrave sipas kategorive të NST 2007

Nr	Kategoritë e mallrave të transportuara sipas NST*	Mallra gjithsej në ton	
		Tr I - 2023	Tr I - 2024
	Gjithsej	1.618.695	1.673.178
1	Produktet bujqësore, gjuetisë, pyjeve dhe peshku dhe produktet e tjera të peshkimit	6.686	3.388
2	Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror	185.384	121.868
3	Produktet metalike dhe të minierave dhe produkte të tjera të gurëve; torfe; uranium dhe torium	27.513	12.823
4	Produkte ushqimore, pijeve dhe duhanit	22.009	35.252
5	Tekstile dhe produkte tekstili; lëkurë dhe produkte lëkure	841	370
6	Druri dhe produktet e drurit dhe produktet me tapë (përveç mobilie); artikujt prej kashte dhe materialeve thurës; pulpë, letër dhe produkte letre; materialet e shtypura dhe mediat e regjistruara	21.492	24.080
7	Koks dhe produktet e rafinuara të naftës	281.798	246.422
8	Kimikate, produkte kimike, dhe fibra të bëra nga njeriu; produkte gome dhe plastike, karburant bërthamor	26.749	32.048
9	Produkte të tjera minerale (jo metalike)	176.054	176.389
10	Metale bazë; produkte metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve	211.329	286.741
11	Makineri dhe pajisje; Pajisje zyre dhe kompjuter; makineri elektrike dhe aparatura si radio, televizion dhe pajisjet e komunikimit; instrumentet mjekësorë dhe orë	49	2.262
12	Pajisje transporti	404	344
13	Mobilie; mallra të tjerë të përpunuar të p.k.v	0	0
14	Lëndë të para të ricikluara; Mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturinat e tjera	7.121	5.471
15	Pako postare	0	0
16	Pajisje dhe materiale që përdoren në transportin e mallrave	21.808	31.607
17	Mallra të lëvizura në rrugën e zhvendosjes së familjeve dhe zyrave; bagazheve të transportuara të ndara nga ato të udhëtarëve; automjetet të transportuara për riparim; mallra jo tregtare të tjera.	0	0
18	Mallra të grupuara: një përzierje e llojeve të mallrave të cilat janë transportuar së bashku	7.676	8.447
19	Mallra të pidentifikuara: mallrat që për ndonjë arsye nuk mund të identifikohen dhe për këtë arsye nuk mund të caktohet në grupe 01-16.	621.782	685.666
20	Mallra të tjera të p.k.v	0	0

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

*Volumi i mallrave të transportuar me det përfshin mallrat e transportuar me anije dhe traget

Numri i anijeve të hyra dhe të dala nga portet në vend rezulton 304 anije, nga këto 178 anije janë të huaja dhe 126 anije vendase. Numri i anijeve të hyra dhe të dala në porte është rritur me 56,7 %, ku numri anijeve të huaja është rritur me 4,7 %, krahasuar me tremujorin e parë 2023.

Portet detare ku kryhet **transporti pasagjerëve** në vend janë: Porti i Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe porti i Shëngjinit. Lëvizja e pasagjerëve në tremujorin e parë 2024 është kryer nga porti i Durrësit, Vlorës dhe porti i Sarandës.

Tab.3: Transporti Detar i pasagjerëve

Pasagjerë	TR I – 2022	TR II – 2022	TR III – 2022	TR IV – 2022	TR I – 2023	TR II – 2023	TR III – 2023	TR IV - 2023	TR I - 2024
Portet gjithsej	121.349	222.991	825.290	197.378	138.242	280.914	988.241	197.377	135.680
Porti Durrës	101.962	121.336	445.712	133.669	109.961	129.218	461.070	127.603	109.722
Hyrje	39.384	63.853	210.026	78.253	41.615	69.780	221.357	77.087	43.203
Dalje	62.578	57.483	235.686	55.416	68.346	59.438	239.713	50.516	66.519
Porti Vlorë	14.371	28.082	124.051	31.671	21.638	23.370	147.570	20.581	15.765
Hyrje	6.761	14.534	57.847	18.073	9.241	12.944	70.412	12.303	6.600
Dalje	7.610	13.548	66.204	13.598	12.397	10.426	77.158	8.278	9.165
Porti Sarandë (Limjoni)	5.016	73.573	255.527	32.038	6.643	128.326	379.601	49.193	10.193
Hyrje	2.416	37.075	126.166	15.820	3.299	65.277	186.302	24.440	4.875
Dalje	2.600	36.498	129.361	16.218	3.344	63.049	193.299	24.753	5.318
Porti Shëngjin	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Hyrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dalje	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar nëpërmjet porteve detare në vend është 135.680 persona.

Porti i Durrësit është porti kryesor në vend nga i cili kanë udhëtuar 80,9 % e pasagjerëve, ndjekur nga porti i Vlorës me 11,6 % dhe më pas porti i Sarandës me 7,5 %.


Eksportet/importet e mallrave me det

Në tremujorin e parë 2024, volumi i mallrave të tregtuara me det (eksport dhe import) është 1.316,8 mijë ton. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, ky tregues është rritur me 1,9 %.

Volumi i mallrave të eksportuara me det në tremujorin e parë 2024 zë 40,0 % ndaj totalit të volumit gjithsej të mallrave të eksportuara.

Volumi i mallrave të importuara me det në tremujorin e parë 2024 zë 64,5 % ndaj totalit të volumit gjithsej të mallrave të importuara.

Fig 1: Eksport/import i mallrave me det, ton



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ilogaritje INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë tremujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete lundruese detare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Port statistikor - Një port statistikor përbëhet nga një ose më shumë porte, të kontrolluara normalisht nga një autoritet i vetëm porti, në gjendje të regjistrojë lëvizjet e anijeve dhe ngarkesave.

Porti i ngarkimit - Quhet porti ku mallrat ngarkohen në anije dhe transportohen prej saj.

Porti i shkarkimit - Quhet porti ku mallrat janë shkarkuar nga anija pasi janë transportuar prej saj.

Transport ndërkombëtar detar - Quhet transporti detar mes dy porteve i lokalizuar në dy vënde të ndryshme.

Pasagjerë detar - Çdo person që kryen një udhëtim në det në një anije tregtare.

Pasagjerë të embarkuar (të dalë) - Janë pasagjerë të cilët kanë hipur në anije dhe transportohen prej saj.

Pasagjerë të disembarkuar (të hyrë) - Janë pasagjerë të zbritur nga anija pasi janë transportuar prej saj.

Pasagjerë/kilometër - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një pasagjerinë një anije tregtare mbi një kilometër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i katërt, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i katërt, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: transport rrugor, hekurudhë, transport ujor i brendshëm dhe transport detar.

Të dhënat e transportit detar janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash